



Republika e Kosovës

Република Косово / Republic of Kosovo

Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of
Communities and Return*

POLITIKA E PRIVATËSISË

Hyrje

Ministria për Komunitete dhe Kthim (në vijim: “Ministria”), si institucion publik, është e përkushtuar për të mbrojtur dhe përpunuar të dhënat personale të të gjitha palëve në mënyrë të drejtë, të ligjshme dhe transparente. Politika e Privatësisë është hartuar në përputhje me **Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, si dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Kjo Politikë e Privatësisë zbatohet për të gjitha rastet kur ndërveproni me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, përfshirë: aplikimet për mbështetje, aplikimet për punë, pjesëmarrjen në ngjarje apo takime, ofrimin apo pranimin e shërbimeve, si dhe dërgimin e kërkesave përmes email-it apo faqes sonë zyrtare të internetit. Ministria ka vendosur masa të sigurisë për të siguruar përpunimin e drejtë dhe të sigurt të të dhënave tuaja personale. Politika zbatohet vetëm për web faqen zyrtare të Ministrisë, ndërsa për faqet tjera të lidhura përmes linqeve, ju rekomandojmë të lexoni politikat përkatëse të privatësisë të atyre faqeve.

Kjo politikë mund të përditësohet herë pas here. Çdo ndryshim do të publikohet në këtë faqe dhe do të hyjë në fuqi menjëherë pas publikimit. Ju inkurajojmë të rishikoni periodikisht këtë dokument. Informacione shtesë për përpunimet jashtë uebfaqes do të ofrohen veçmas, sipas rastit.

Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale

Ministria për Komunitete dhe Kthim përpunon të dhëna personale të qytetarëve dhe palëve të tjera për të realizuar detyrat dhe shërbimet institucionale në kuadër të mandatit të saj ligjor. Këto përfshijnë trajtimin e kërkesave për kthim, ofrimin e mbështetjes sociale dhe integritit, zbatimin e programeve për zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve, si dhe menaxhimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët, institucionet dhe organizatat partnere. Gjithashtu përpunimi kryhet për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe raportimin ndaj institucioneve përgjegjëse.

Të dhënat personale të mbledhura përmes faqes sonë zyrtare të internetit përdoren vetëm për qëllime të qarta dhe të përcaktuara, duke përfshirë transparencën në ndarjen e mbështetjes financiare dhe materiale për komunitetet, si dhe për të mundësuar qasje të sigurt në shërbimet dhe informacionet online.

Ministria nuk përdor të dhënat personale për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë mbledhur dhe nuk i shpërndan ato për marketing të drejtpërdrejtë apo qëllime komerciale.

Sipas ligjit, të dhënat personale mund t'i bëhen të ditura vetëm palëve të treta të autorizuar me ligj, përfshirë autoritetet e zbatimit të ligjit, dhe vetëm kur kjo është e nevojshme, e arsyeshme dhe për qëllime të përcaktuara qartë.

Të dhënat ruhen vetëm për periudhën që është e nevojshme për realizimin e qëllimeve të përpunimit. Në raste të veçanta, ato mund të ruhen për periudha më të gjata me qëllime statistikore, historike ose monitorimi të projekteve, duke garantuar masa të përshtatshme të mbrojtjes dhe sigurisë.

Baza Ligjore

Përpunimi i të dhënave personale nga Ministria për Komunitete dhe Kthim bazohet në nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe mbështetet në disa akte ligjore, varësisht nga qëllimi i përpunimit. Këto përfshijnë përmbushjen e detyrimeve ligjore që i ngarkohen Ministrisë, realizimin e detyrave në interes publik apo ushtrimin e autoritetit zyrtar të saj, si dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në rastet kur ata kanë paraqitur kërkesë për ndihmë/asistencë, apo në ndonjë nderveprim apo shërbim tjetër.

Të dhënat personale dhe faqja zyrtare e internetit

Në epokën e komunikimit digjital, faqja zyrtare e internetit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim shërben si kanal kyç për transparencë dhe ofrim të informacionit dhe shërbimeve ndaj qytetarëve, në veçanti për komunitetin jo shumicë. Përmes kësaj platforme, Ministria publikon informacione të rëndësishme për misionin e saj, dokumente ligjore dhe nënligjore, thirrje publike për aplikim, njoftime për komunitetet jo shumicë, informacione për programet e mbështetjes, proceset e rekrutimit, si dhe aktivitete të tjera institucionale.

Të gjitha përmbajtjet dhe shërbimet që ofrohen përmes kësaj faqeje realizohen në përputhje me:

- Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike,
- Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe
- Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre që nuk janë shumicë në Kosovë, është një nga shtyllat themelore ligjore që garanton të drejtat dhe përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në jetën publike dhe politike, dhe përkon drejtpërdrejt me mandatin e Ministrisë për t'i mbështetur këto komunitete.

Disa nga funksionalitetet e faqes mund të kërkojnë përpunimin e të dhënave personale, për shembull gjatë aplikimeve, dërgimit të kërkesave apo komunikimit përmes formave elektronike. Ministria garanton që përpunimi i të dhënave personale në këto raste bëhet në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të sigurt, duke respektuar parimet e mbrojtjes së të drejtave themelore të individëve dhe komuniteteve.

Kategoritë e të dhënave personale të përpunuara nga Ministria

Varësisht nga qëllimi i përpunimit, Ministria mund të përpunojë këto kategori të të dhënave:

- ✓ Të dhëna identifikuese (emri, mbiemri, numri personal, data e lindjes);
- ✓ Të dhëna kontaktuese (adresa, email, numri i telefonit);
- ✓ Të dhëna sociale dhe ekonomike (statusi familjar, gjendja ekonomike);
- ✓ Të dhëna që lidhen me përkatësinë komunitare (për qëllime të mbrojtjes, integritetit dhe zhvillimit të komuniteteve);
- ✓ Të dhëna që lidhen me mbështetjen përmes projekteve të ndryshme;
- ✓ Të dhëna për arsimin, shëndetin, kualifikimet profesionale dhe përvojën e punës;
- ✓ Të dhëna të tjera personale të kërkuara në bazë të ligjeve për marrëdhëniet e punës dhe kontratat publike;
- ✓ Të dhëna të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe statutore të Ministrisë;
- ✓ Pamje fotografike dhe video nga konferenca, trajnime, takime apo ngjarje publike të organizuara nga Ministria ose partnerë të saj.

Të drejtat tuaja

Sipas Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ju keni të drejta të qarta dhe të garantuara lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Në çdo kohë, ju keni të drejtë të dini se si përpunohen të dhënat tuaja personale dhe për çfarë qëllimi. Ju keni të drejtë të kërkonit qasje në të dhënat tuaja personale dhe, nëse ato janë të pasakta ose të paplota, të kërkonit korrigjimin ose përditësimin e tyre pa vonesë.

Gjithashtu, ju keni të drejtë të merrni kopje të të dhënave tuaja në një format të strukturuar dhe të përdorshëm elektronikisht, në mënyrë që t'i transferoni ato tek një tjetër kontrollues i të dhënave, në përputhje me të drejtën për transferim të të dhënave.

Në rast se besoni se të drejtat tuaja lidhur me mbrojtjen e të dhënave janë shkelur, ju keni të drejtë të paraqisni ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi apo institucioneve tjera përkatëse.

Si të ushtroni të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave

Në rast se Ministria për Komunitete dhe Kthim përpunon të dhënat tuaja personale dhe dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja lidhur me mbrojtjen e tyre, ju lutemi të na dërgoni një kërkesë me shkrim në adresën tonë zyrtare: Ministria për Komunitete dhe Kthim, Rr. Nëna Terezë, pn. 12000 Fushë Kosovë/ Republika e Kosovës. Gjithashtu, mund të kontaktoni Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Ministri në adresën e-mail: aferdita.aliu@rks-gov.net.

Në parim, nuk pranohen kërkesa verbale (telefonike ose ballë për ballë) për arsye se kërkesat duhet të analizohen me kujdes dhe për t'ju identifikuar në mënyrë të besueshme.

Kërkesa juaj duhet të përmbajë përshkrim të detajuar të të dhënave personale që lidhen me kërkesën tuaj. Në rast dyshimesh të arsyeshme mbi identitetin tuaj, mund t'ju kërkohej që të siguronit informacion shtesë për verifikim. Të gjitha të dhënat e mbledhura për verifikimin e identitetit do të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe nuk do të ruhen më gjatë se sa është e nevojshme.

Autoriteti mbikëqyrës

Nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale janë shkelur nga ana e Ministrisë dhe nuk jeni të kënaqur me përgjigjen që keni marrë nga ne, ju keni të drejtë të paraqisni ankesë pranë autoritetit mbikëqyrës:

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)

Adresa: Rruga “Zejnel Salihu”, Nr. 22, (ish objekti i Gjykatës Themelore) Prishtinë, 10000, Kosovë.

Email: info@aip-rks.org

Ueb: www.aip-rks.org

AIP është autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës.

Siguria e të dhënave personale

Ministria për Komunitete dhe Kthim zbatonë masa të përshtatshme fizike, organizative dhe teknike për të siguruar mbrojtjen e të dhënave tuaja personale, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale përcaktohet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe rregullohet me Ligjin për Arkivat Shtetërore, si dhe me ligjet e tjera përkatëse në fuqi.

Përditësimi i Politikës së Privatësisë

Ne mund të përditësojmë herë pas here politikën tonë të privatësisë dhe do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke postuar Politikën e re të privatësisë në këtë faqe.

Faqja e internetit mund të përmbajë linqe të ndryshme të faqeve të tjera të internetit, për të cilat ju rekomandojmë të i lexoni politikat e privatësisë të faqeve të tyre.

Përmbyllje

Ministria për Komunitete dhe Kthim mbetet e përkushtuar që të sigurojë një trajtim të drejtë, të sigurt dhe në përputhje me ligjin të të dhënave personale të të gjithë palëve të përfshira në aktivitete e saj, duke respektuar të drejtat e çdo individi dhe duke promovuar transparencë në të gjitha proceset e saj. Mbrojtja e privatësisë është pjesë përbërëse e misionit tonë për të garantuar kthimin e qëndrueshëm dhe integrimin e plotë të komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës.